



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:094412

Datë: 23.11.2023

Numri i dokumentit: 04961037

P.nr.140/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Dibran Jusufi, me bashkëpunëtoren profesionale Sadete Kuqi Berisha, në çështjen penale kundër të pandehurit S.K., për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë me numër PP.II.nr.8016/17 e datës 18.01.2018, jashtë seancës duke vepruar sipas detyrës zyrtare, me datë 23.11.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. HEDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.nr.8016/17, e datës 18.01.2018, e paraqitur ndaj të pandehurit S.K. për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-ës dhe PUSHOHET procedura penale në këtë çështje penale, ngase ka kaluar koha e parashikuar me ligj për parashkrim absolut të ndjekjes penale.

II. E dëmtuara KEDS për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

III. Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë me datë 19.01.2018, në këtë gjykatë ka dorëzuar aktakuzën me numër, PP.II.nr.8016/17 e datës 18.01.2018 kundër të pandehurit S.K., për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-ës.

Gjyqtari i çështjes me këtë lëndë është ngarkuar me datë 04.09.2023, me ç ‘rast pas analizimit dhe shikimit të të gjitha provave dhe përkundër ndërmarrjes së gjitha veprimeve ligjore në mënyrë që të sigurohet prezenca e të pandehurit dhe që ndaj tij të zhvillohet procedura penale konsideron se vepra penale e cila i vihet në barrë të pandehurit të lartcekur, tanimë është përfshirë në parashkrim të ndjekjes penale sepse nga koha e kryerjes së veprës penale e deri më tani kanë kaluar më tepër se 6 vite, kohë kjo që shpie në parashkrim absolut të ndjekjes penale.

Nga shkresat e lëndës shihet se i pandehuri, veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-ës sipas aktit akuzues së lartcekur, dyshohet se e ka kryer me datë 26.10.2017, ku për këtë lloje të veprës penale dënimi sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës me numër 04/L-082, është e dënueshme me gjobë dhe dënim me burgim deri në 3 vjet.

Në nenin 106 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të KPRK-së është përcaktuar se “ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar tre (3) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një (1) vit burgim”, ndërsa në nenin 107 paragrafi 8 të KPRK-së, është parashikuar se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse ka kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale), e në rastin konkret kanë kaluar më tepër se gjashtë (6) vite, kur dyshohet se është kryer vepra penale e lartcekur.

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim absolut të ndjekjes penale dhe në bazë të nenit 357 paragrafi 1 nën paragrafi 1. 3, si dhe nenit 453 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale lidhur me nenin 106 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të KPRK-ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

P.nr.140/18

Me datë 23.11.2023

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Dibran Jusufi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës, brenda afatit prej 5 (pesë) ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.